

# **RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2003**

## ***Hyrje***

Viti 2003 ishte viti më i suksesshëm pas përfundimit të luftës si në pasurimin e koleksioneve të bibliotekës ashtu edhe në realizimin e shërbimeve dhe aktiviteteve të larmishme që u zhvilluan në këtë bibliotekë. Angazhimi i drejtpërdrejtë i Ministrisë për Kulturë, respektivisht i Sektorit për biblioteka për t'u marrë me zhvillimin dhe përparimin e të gjitha bibliotekave ndërkomunale, prandaj dhe të Bibliotekës Ndërkomunale "Hivzi Sulejmani" në Prishtinë, ishte në nivel të kënaqshëm. Gjithashtu, përkrahja e Drejtorisë për Kulturë të Komunës së Prishtinës, si në pasurimin e fondeve ashtu edhe në fushat e tjera, ishte një kontribut tjetër mjaft i çmueshëm. Megjithatë mbetet shumë për t'u dëshiruar që të arrihet një shkallë më e lartë e zhvillimit dhe e përparimit të kësaj Biblioteke, duke shpresuar në rritje të përhershme të buxhetit, qoftë për pasurimin e fondit të koleksioneve, qoftë për veprimtari bibliotekare dhe aktivitete të tjera nga lëmi i kulturës. Gjatë këtij viti kemi një rritje të numrit të anëtarëve dhe rezultate më të mira në realizimin e shërbimeve të planifikuara se në vitin paraprak, fakt që tregon se lexuesit gradualisht po i kthehen librit.

## ***Veprimtaria dhe lloji i aktiviteteve***

Ky vit ishte i suksesshëm edhe me aktivitete lidhur me librin dhe kulturën, në punë profesionale, të renovimit dhe të pajisjes me inventar të ri, por edhe të projekteve të ndryshme. Këto suksese të Bibliotekës nuk mbetën pa u shënuar nga shumë mjete tona të informimit, duke njoftuar për to opinionin e gjerë të vendit dhe më larg.

## ***Punët profesionale***

Me qëllim të rritjes së cilësisë së veprimtarsë bibliotekare dhe aktiviteteve kulturore, këtë vit, nga një konkurs i shpallur nga Ministria e Kulturës u pranuan tre punëtorë të rinj: 2 bibliotekarë me fakultet të kryer, njëri në Sektorin e pasurimit dhe përpunimit të librit dhe tjetra për punën me fëmijë

në degën e “Bibliotekës Përkujtimore” dhe një pastruese që ishte një nevojë dhe kërkesë e mëhershme e drejtorisë së bibliotekës.

Me ndihmën e Drejtorisë për Kulturë të Komunës së Prishtinës u bë rihapja e bibliotekës- dega në Keqekollë që ishte një ngjarje me rëndësi për banorët e këtij fshati. Objekti është në kuadër të Shtëpisë së Kulturës dhe është mjaft i përshtatshëm. Ka depon e librit dhe sallën e leximit. Një ekip i bibliotekës ka punuar 4-5 ditë në përpunimin dhe radhitjen e fondit të librave. U pranua një punëtor-librar, cili u trajnuar një kohë në bibliotekën tonë. Përrurimi u bë me 2 tetor 2003, kur edhe rifilloi punën kjo bibliotekë që nuk kishte punuar që nga koha e luftës. Gjithashtu është bartë fondi i librit të degës në Bardhosh nga objekti i mëparshëm në objekt të renovuar dhe më të përshtatshëm, pranë shkollës dhe kjo ka ndikuar në zgjimin e interesimit dhe shtimin e anëtarëve të regjistruar. Edhe në Sallën e leximit u punua në lirim të vendeve për tituj të rinj. U hoqën ekzemplarët e tepërt në fondin rezervë.

### **Koordinimi i punës me bibliotekat komunale**

Biblioteka Ndërkomunale “Hivzi Sulejmani” e ka obligim mbikëqyrjen profesionale të bibliotekave Komunale të Lypjanit, Besianës, Drenasit, Fushë Kosovës dhe Kastriotit. Këtë vit me kërkesën e udhëheqësit të Bibliotekës së Lypjanit, një ekip i bibliotekës bëri një vizitë pune në këtë bibliotekë. Vizita kishte për qëllim dhënien e këshillave profesionale lidhur me organizimin e punës, organizimit të sektorëve, përpunimit të librit, radhitjes së fondeve, antarësimit të lexuesve etj. Për shkak se biblioteka është hapur edhe për nacionalitetin serb, udhëzimet tona dhe radhitja e fondeve sipas standardeve ndërkombëtare të IFLA-s, ndikuan që biblioteka të mos ndahet në dy pjesë, por të punojë si e tërë.

### **Trajnimet**

Kërkesat për trajnim profesional në adresën e bibliotekës sonë po shtohen vazhdimisht. Edhe këtë vit janë trajnuar tre punëtorë: një nga biblioteka e Keqekollës, një nga biblioteka e Fushë Kosovës dhe një nga Fakulteti i Gazetarisë. Këtë vit BKUK-ja organizoi një seminar 2 ditor rreth aktiviteteve në bibliotekat me fëmijë, ku morën pjesë 6 punëtorë nga biblioteka jonë. Ligjëruese ishte një specialiste për aktivitetet me fëmijë nga Zara .

## ***Aktivitetet kulturore***

### **Shpërblimet dhe mirënjohjet**

Edhe gjatë këtij viti u shënuan disa aktivitete të rëndësishme kulturore. Siç është bërë tashmë edhe traditë, në gjysmën e janarit u dhanë shpërblimet për tre lexuesit më të mirë të vitit 2002 dhe u shpallën dy librat më të lexuar të vitit. Ky shpërblim u takoi Njomzë Aliut, nxënëse e kl. VIII dhe Arben Atashit, student i shkallës së tretë, të cilët u shpërblyen me nga një komplet librash, kurse veprat më të lexuara u shpallën “Aventurat e Tom Sojerit” e Mark Tuenit dhe “Lahuta e Malcisë” e Gjergj Fishtës. Duke e parë interesimin e të moshuarve për librin, këtë vit me një mirënjohje dhe një punim artistik u shpërblye pensionistja Advije Shehu. Gjithashtu mirënjohje ju dhanë edhe dy dhuruesve më të dalluar të librit, Hasan Hasanit dhe Ramiz Hoxhës, të cilë kontribuan në pasurimin e koleksioneve të bibliotekës. Ndarja e shpërblimeve u bë në mënyrë solemne dhe në prezencë të mediave. Në bashkëpunim me shkollën fillore “Gjergj Fishta”, në sallën e “Bibliotekës Pwrkujtimore” u shënuar 7 Marsi-Dita e Mësuesit, me ç’rast u dha një program kulturo-letrar nga nxënësit. Ishte i pranishëm edhe veterani Sabit Uka dhe disa shkrimtarë për fëmijë. Punimet më të mira: 3 nga krijimet letrare dhe 3 nga arti figurativ, të vlerësuara nga dy juri, u shpërblyen me libra dhe vegla të artit figurativ.

### **Vizitat**

Një ngjarje që bëri jehonë këtë vit, ishte „Java e bibliotekës në Kosovë“, e cila u manifestua për herë të parë në Kosovë dhe përkonte me javën e bibliotekës në Amerikë. Organizatore ishte BKUK. Prej 7-13 prill u organizuan aktivitete të shumta: promovime librash, ekspozita, seminare, tryeza pune. Mysafir nga Biblioteka e Kongreseve ishte specialiti Z. Grant Harris, i cili e vizitoi edhe bibliotekën tonë me 11 prill 2003. Me këtë rast u shkëmbyen mendime lidhur me veprimtarinë bibliotekare dhe bashkëpunimin mes bibliotekave dhe në fund iu dhuruan dy libra nga drejtori i Bibliotekës, një për Bibliotekën e Kongresit Amerikan dhe një për vetë z. Harris.

### **Klubi i Letrararëve të Rinj të Bibliotekës**

Formimi i Klubit të Letrarëve të Rinj, i cili do të veprojë në kuadër të Bibliotekës Ndërkomunale “Hivzi Sulejmani”, ishte një ngjarje e rrallë në historinë e bibliotekave. Ky klub u formua përmes një konkursi për poezi që u botua në gazetën “Koha ditore”, ku u parapanë edhe shpërblimet për tri

poezitë më të mira, të vlerësuara nga juria profesionale që e kishte formuar Biblioteka. Klubi e nisi aktivitetin me 35 anëtarë, kurse aktualisht numron 45 anëtarë. Janë mbajtur brenda kësaj periudhe më se dhjetë takime; një orë letrare në fakultetin filologjik dhe aktivitete të tjera të rëndësishme.

### **Promovimet**

Janë organizuar 3 promovime të librave të vetë krijuesve të Klubit: 1. “Dhimbja e krijimit” e Kushtrime Ibras, 2. “Ta dëgjoj jetën” përmbledhje e poezive të anëtarëve të Klubit dhe 3. “Shtegtim në buzëqeshje” të autorit Hazir Luta.

### **Botimet e Bibliotekës**

Suksesi më i madh i Bibliotekës gjatë gjithë rrugëtimit të saj do të konsiderohet ndërmarrja e rolit të botuesit, ku vetëm brenda 3 muajsh arriti të botojë dy libra: 1. “Ta dëgjoj jetën” (të përmendur më lartë) dhe 2. “Mbi syprinë të shpresës” të Donjeta Gashit. Mjetet për botimin e librit të parë i siguroi Biblioteka, kurse për dytin Drejtoria për Kulturë e komunës së Prishtinës.

### **Ekspozitat**

Titujt e blerë dhe të dhuruar të librave gjatë vitit 2003 u bënë të njohura për lexuesit dhe opinionin përmes dy ekspozitave.

Ekspozita e parë u hap në degën e Pallatit të Rinisë, në kuadër të manifestimit „Muaji i Rinisë“, ku u ekspozuan titujt e librave të kësaj dege që kanë hyrë gjatë viteve 2002-2003, me 355 tituj.

Ndërsa, në kuadër të Muajit dërkombëtar të librit, në Galerinë e Ministrisë së Kulturës u hap ekspozita tjetër me titull “Titujt e koleksioneve të bibliotekës 2003“ me 1096 tituj. Ekspozita u përcoll nga mediat elektronike dhe shtypi ditor. Qëndroi e hapur prej 13-18 nëntor dhe ishte mjaft e vizituar.

### **Takime me shkrimtarë dhe krijues**

Në degët e bibliotekës që punojnë me fëmijë u organizuan katër takime me krijues. Në degën „Përrallat“ u mbajt takimi me shkrimtarët për fëmijë Avdi Shala dhe Agim Deva dhe me aktorin Avni Hotin, kurse në degën „Biblioteka Përkujtimore“ u mbajt takimi i fëmijëve me gazetaren për fëmijë Shqipe Halili.

### ***Renovimet dhe pajisja me inventar***

Gjatë këtij viti u bënë disa renovime dhe përtëritje e inventarit.

Në degën “Përkujtimore” u bë riparimi i ngrohjes qëndrore. Në degën në Pallatin e Rinisë u bë klimatizimi i sallës së leximit.

Gjatë këtij viti disa sektorë u pajisën me inventar të ri si tavolina pune, vitrina etj. Gjithashtu biblioteka u pajis me mjete të reja teknologjike si : printerë, faks e material tjetër të domosdoshëm për zhvillimin e veprimtarisë sonë.

Një renovim i objektit dhe pajisja me rafte të reja u bë edhe në degët e bibliotekës në Keqekollë dhe në Bardhosh. Në degët në fashatra u siguruan mjetet e ngrohjes për të cilat u kujdes Drejtorati për Kulturë i Komunës së Prishtinës.

### ***Pasurimi dhe përtëritja e koleksioneve dhe e periodikut***

Në vitin 2003 kishte një kthesë pozitive kur është fjala për pasurimin e bibliotekës me tituj të rinj. Përveç mjeteve të ndara nga Ministria e Kulturës që ishin dyfish më shumë se vitin e kaluar, kemi pasur një përkrahje të madhe edhe nga Drejtoria për Kulturë e Komunës së Prishtinës. Këtë vit janë blerë 617 tituj me 3578 ekzemplarë të librave. Gjithashtu, biblioteka është pasuruar nga dashamirët e librit me 684 tituj dhe 1401 ekzemplarë të librit. Gjithsej në vitin 2003 në këtë bibliotekë kanë hyrë 1302 tituj me 5017 ekzemplarë të librit.

Edhe furnizimi me periodik në vitin 2003 ishte më i mirë. Në Bibliotekën qendrore për çdo ditë merren 4 gazeta të përditshme, ndër më të kërkuarat, dhe lexohen mjaft nga përdoruesit e Bibliotekës. Tri nga këto: “Zëri”, “Koha Ditore” dhe “Epoka e re” na janë mundësuar falas nga redaksitë e tyre, kurse gazetën “Bota sot” e paguajmë. Tri prej këtyre gazetave “Bota sot”, “Koha ditore” dhe “Zëri” lidhen dhe ruhen në arkiv të bibliotekës.

Në disponim të lexuesve janë revistat: “Zëri javorë”, “Kosovarja”, “Fjala”, “Shkëndija”, “Prishtina” dhe “Jeta e re”, të cilat i marrim pa pagesë.

Ndërsa kur është fjala për lexuesit e vegjël, kemi një ngecje. E marrim vetëm „Pionierin“ edhe atë jo në mënyrë të rregullt.

### ***Të dhëna të veçanta për të gjithë sektorët dhe degët***

Brenda bibliotekës funksionojnë **këta sektorë**: Sektori i Përparimit dhe zhvillimit të bibliotekarisë, 2. Sektori i Pasurimit dhe Përpunimit të librit, 3. Sektori i Bibliotekës për fëmijë, 4. Sektori i Bibliotekës për të rritur, 5. Sektori i Sallës së leximit dhe Periodikut, 6. Sektori i ruajtjes së trashëgimisë (i vendit) dhe 7. Sektori i punëve të përbashkëta.

**Degët në qytet**: 1. Biblioteka Përkujtimore , 2. „Përrallat“, 3. Biblioteka në Pallatin e Rinisë, 4. „Lektura“.

**Degët në fshatra**: 1. dega në Llukar, 2. në Koliq, 3. në Bardhosh , 4. në Hajvali, 5. në Slivovë, 6. në Keqekollë, 7. në Gracanië, 8. Çagllavicë dhe 9. në Ll. Sellë.

### ***Sektori i Përparimit dhe zhvillimit bibliotekar***

Ky sektor ka filluar veprimtarinë kah mesi i këtij viti dhe ka përcjellë punën profesionale të të gjithë sektorëve dhe degëve të bibliotekës, por edhe të 5 bibliotekave komunale. Gjithashtu, ka përcjellë botimet e reja dhe ka bërë hartimin e projekteve të ndryshme për blerje të librit sipas kërkesave të kohës dhe të lexuesve. Është angazhuar në mbledhjen dhe analizën e raporteve të punës për të gjithë sektorët dhe degët e bibliotekës dhe të bibliotekave komunale. Të gjitha këto raporte të paraqitura me shkrim dhe në formë tabelare janë dërguar në Ministrinë e Kulturës, sektorit për biblioteka, Drejtoratit për Kulturë Rini dhe Sport të Komunës së Prishtinës dhe BKUK-ut. Përveç të tjerash, ky sektor bënë organizimin e punëve dhe hartimin e projekteve të ndryshme, sipas nevojës.

### ***Sektori i Pranimit dhe Përpunimit të librit***

Është ndër sektorët e rëndësishëm të bibliotekës, kurse punëtorët e tij kanë një përgatitje të lartë profesionale dhe kanë përcjellë të gjitha risitë dhe ndryshimet në fushën e bibliotekarisë të cilat janë aplikuar. Ky sektor është angazhuar që gjithë librat e hyrë t'i përpunojë sipas standardeve ndërkombëtare: përpunimin fizik, klasifikimin, inventarizimin, katalogimin e librit, sistemimin e skedarit në katalogun qendror dhe shpërndarjen nëpër sektorë dhe degë të Bibliotekës për shfrytëzim nga lexuesit. Përveç kësaj, janë angazhuar dhe kanë bërë një punë të vlefshme edhe nëpër disa sektorë të tjerë dhe degë të Bibliotekës: përgatitja e librave për ekspozitë, trajnimi i punëtorëve, rregullimi i fondeve të degëve të bibliotekës, zëvendësimi nëpër sektorë në mungesë të punëtorit dhe veprimtari tjera aty ku është paraqitur nevoja. Pothuajse të gjitha materialet

bibliotekare që kanë hyrë në bibliotekë gjatë vitit 2003 janë përpunuar dhe janë shpërndarë nëpër sektorë dhe degë të bibliotekës.

### **Treguesi i shërbimeve**

|                      |                        |
|----------------------|------------------------|
| Pranimi i librit     | 1302 tituj, 5017 libra |
| Përpunimi fizik      | 6606 libra             |
| Klasifikimi          | 2459 tituj, 5760 kopje |
| Inventarizimi        | 6292+526 libra         |
| Çregjistrimi         | 290 libra              |
| Kompenzimi           | 48 libra               |
| Katalogimi           | 1613 libra             |
| Skedarë të shkruar   | 8043 njësi             |
| Skedarë të printuar  | 6740 njësi             |
| Skedarë të sistemuar | 3703 njësi             |

### **Sasia e librit të përpunuar sipas KUD-it**

|   |            |
|---|------------|
| 0 | 309 libra  |
| 1 | 109 libra  |
| 2 | 58 libra   |
| 3 | 388 libra  |
| 4 | 19 libra   |
| 5 | 42 libra   |
| 6 | 63 libra   |
| 7 | 5086 libra |
| 9 | 218 libra  |

### **Shpërndarja e librit sipas sektorëve dhe degëve**

|   |            |
|---|------------|
| 1. Sektori i Bibliotekës për fëmijë           | 630 libra  |
| 2. Sektori i Bibliotekës për të rritur        | 965 libra  |
| 3. Sektori i Sallës së leximit dhe Periodikut | 253 libra  |
| 4. Sektori i Bibliotekës së Vendit            | 1228 libra |
| 5. dega në Pallatin e Rinisë                  | 551 libra  |
| 6. dega „Lektura“                             | 229 libra  |
| 7. dega Biblioteka Përkujtimore               | 399 libra  |
| 8. dega „Përrallat“                           | 172 libra  |
| 9. Dega në Hajvali                            | 124 libra  |
| 10. dega në Llukar                            | 139 libra  |
| 11. dega në Koliq                             | 89 libra   |

|                       |                   |
|-----------------------|-------------------|
| 12. dega në Slivovë   | 109 libra         |
| 13. dega në Bardhosh  | 214 libra         |
| 14. dega në Keqekollë | 366 libra         |
| <b>gjithsej</b>       | <b>5468 libra</b> |

### ***Sektori i Bibliotekës për fëmijë***

Ky sektor i rëndësishëm dhe mjaft i frekuentuar nga lexuesit i ka kryer detyrat e parashtruara, por ka dhënë ndihmesë edhe në punë të tjera kur është paraqitur nevoja si: përpunimi fizik, inventarizimi, hartimi i listave të librave, punë me kompjuter etj. Numri i lexuesve pothuajse është i njejtë me vitin e kaluar (2 anëtar më pak). Ky sektor do të kishte dhënë më shumë nga vetja sikur të kishte kushte më të mira dhe hapsirë më të madhe për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme kulturore, por edhe literature më të larmishme. Gjatë këtij viti punëtorët e këtij sektori kanë marrë pjesë në një seminar të organizuar nga BKUK-u për aktivitetet me fëmijë që ishte një përvojë e shkëlqyer.

#### **Treguesi i shërbimeve**

|                                |      |
|--------------------------------|------|
| Anëtarë të regjistruar         | 569  |
| Libra të lexuar                | 8117 |
| Periodiku                      | 138  |
| Sistemimi i skedarit           | 410  |
| Shfrytëzuesit e sallës së lex. | 507  |

### ***Sektori i Bibliotekës për të rritur***

Punëtorët e këtij sektori janë angazhuar për t'i shërbyer anëtarët e bibliotekës në shfrytëzimin e literaturës së kërkuar, në sistemimin e fondit të koleksioneve, në sistemimin e skedarëve, përgatitjen e librave për ekspozita dhe në veprimtari të tjera.

Në krahasim me vitin e kaluar, në këtë sektor ka rënie të anëtarëve të regjistruar. Si duket në këtë do të ketë ndikuar mungesa e literaturës, edhe pse këtë vit ky sektor është pasuruar me 965 libra të rinj.



**Treguesi i shërbimeve**

|                        |      |
|------------------------|------|
| Anëtarë të regjistruar | 286  |
| Libra të lexuar        | 6286 |
| Sistemimi i skedarëve  | 860  |

***Sektori i Sallës së leximit dhe Periodikut***

Punëtorët në këtë sektor u përpoqën që t'i shërbejnë shfrytëzuesit e sallës me literaturë që atyre u nevojitej dhe me gazetave e revistat që disponon biblioteka. Janë angazhuar edhe në kompletimin dhe lidhjen e gazetave dhe lirim të hapsirë në raftet për fondet e reja. Skedari i përgatitur nga Sektori i Përpunimit të librit u sistemua në të dy katalogët: alfabetik dhe sistematik. Gazetat, pas përfundimit të çdo muaji, u sistemuan dhe u vendosën në vend të caktuar. Nevojë e përhershme në këtë sektor është pasurimi me tituj shkencorë.

**Treguesi i shërbimeve**

|                               |       |
|-------------------------------|-------|
| Anëtarë të regjistruar        | 196   |
| Libra të lexuar               | 3709  |
| Periodiku                     | 34402 |
| Gazeta                        | 30768 |
| Revista                       | 3634  |
| Sistemimi i skedarit          | 617   |
| Shfrytëzues të sallës së lex. | 8221  |

***Dega „Biblioteka Përkujtimore“***

Pas zgjidhjes së problemit të ngrohjes së objektit, në këtë degë të bibliotekës janë krijuar kushtet që të punohet në të dy sallat, gjë që ka ndikuar në rritjen e numrit të lexuesve, shërbimeve si dhe aktiviteteve të larmishme kulturore. Gjithashtu kompletimi kuadrit me një punëtorë me përgatitje universitare ka ndikuar në rritjen e efikasitetit të punës dhe veprimtarisë bibliotekare në përgjithësi. Gjithashtu bashkëpunimi me shkollën “Gjergj Fishta” ka dhënë rezultate të dukshme. Këtë vit kemi një rritje të befasishme të numrit të lexuesve për 200 më shumë se vitin e kaluar. Ky tregues na bënë të besojmë se në vitin 2004 kjo degë do të ketë rezultate edhe më të mira.

***Treguesi i shërbimeve***

|                        |      |
|------------------------|------|
| Anëtarë të regjistruar | 566  |
| Libra të lexuar        | 6542 |

|   |       |
|---|-------|
| Komentim i librave të lex. nga lexuesit | 643   |
| Vizatime                                | 1368  |
| Ilustrime                               | 259   |
| Punime me dorë                          | 273   |
| Punë me kompjuter                       | 171   |
| Ekspozitë nga krijimet e fëmijëve       | 21    |
| Revista të lexuara                      | 561   |
| Shfrytëzues të sallës së lex.           | 13679 |

### ***Dega „Përrallat“***

Kjo degë e Bibliotekës vazhdon të jetë atraktive si për të vegjëlit ashtu edhe për vizitorët e shumtë, qoftë për kushtet që afron, qoftë për format e larmishme të punës dhe aktiviteteve që zhvillohen. Janë të rralla bibliotekat si kjo që u afrojnë të vegjëlve kënaqësi, argëtim, pajisje me dituri dhe shkathtësi. Gjatë këtij vit u organizuan tri takime me krijues. Gjithashtu, gjatë këtij viti kishte një intresim të madh të mediave për punën dhe aktivitetet që zhvillohen në këtë degë të bibliotekës.

Numri i lexuesve është për 5 anëtarë më shumë se vitin e kaluar, por hapësira e pamjaftueshme e dikton edhe numrin e lexuesve.

### ***Treguesi i shërbimeve***

|                                     |       |
|-------------------------------------|-------|
| Anëtarë të regjistruar              | 297   |
| Libra të lexuar                     | 8649  |
| Komentim nga fëmijët                | 3316  |
| Komentim nga librarët               | 1029  |
| Vizatime                            | 2871  |
| Ilustrime                           | 406   |
| Punime dore                         | 241   |
| Demonstrim lojrash me kompjuterë    | 464   |
| Demonstrim me aparate audio-vizuele | 142   |
| Ekspozita pikturash-vizatimesh      | 7     |
| Revista të lexuara                  | 2232  |
| Takime me shkrimtarë                | 3     |
| Shfrytëzues të sallës               | 15881 |

### ***Dega „Lektura“***

Ndonëse me një fond modest librash dhe punës vetëm në një ndërresë, kjo degë ishte mjaft e frekuentuar. Vërehet një rritje e vogël e anëtarëve të regjistruar dhe shërbimeve të realizuara në krahasim me vitin e kaluar. Gjithashtu edhe numri i shfrytëzuesve të sallës së leximit po shtohet dita ditës.

***Treguesi i shërbimeve***

|                        |      |
|------------------------|------|
| Anëtarë të regjistruar | 265  |
| Libra të lexuar        | 4138 |
| Shfrytëzues të sallës  | 1108 |

***Dega në Pallatin e Rinisë***

Biblioteka në Pallatin e Rinisë vazhdon të mbetet biblioteka më e frekuentuar, posaçërisht nga studentët dhe nxënësit. Kushtet e përshtatshme për punë dhe studim si dhe angazhimi i punëtorëve ka ndikuar që numri i përdoruesve të jetë përherë në rritje. Brengë e përhershme mbetet uzurpimi i një pjese të objektit të bibliotekës, gjë që pengon shtimin e anëtarëve të regjistruar dhe veprimtarisë bibliotekare. Edhe pse gjatë vitit 2003 kanë hyrë 551 libra të rinj, kjo degë edhe më tutje duhet të pasurohet, posaçërisht me literaturë shkencore që është kërkesë e përhershme e lexuesve. Në vitin 2003 u ekspozuan titujt e kësaj dege gjatë vitit 2002-2003 përmes një ekspozite që u organizua në kuadër të „Muajit të Rinisë“. Gjithashtu u promovua libri me poezi i autores Kushtrime Ibra.

***Treguesi i shërbimeve***

|                        |       |
|------------------------|-------|
| Anëtarë të regjistruar | 656   |
| Libra të lexuar        | 8685  |
| Gazeta të lexuara      | 13048 |
| Revista të lexuara     | 1299  |
| Shfrytëzues të sallës  | 22851 |
| Sistemimi i skedarit   | 1467  |

***Dega në Llukarë***

Edhe pse kjo degë është shumë afër shkollës së këtij fshati dhe është nga degët më të pasura me libra, me kushte të mira për punë, numri i shfrytëzuesve është fare modest. Numri i anëtarëve është i njëjtë me vitin e kaluar.

|                        |      |
|------------------------|------|
| Anëtarë të regjistruar | 221  |
| Libra të lexuara       | 4340 |

### ***Dega në Koliq***

Punëtori i kësaj dege të bibliotekës, pas vërejtjeve që ka marrë nga drejtori i Bibliotekës dhe Zyra Ligjore e Ministrisë, është më i përgjegjshëm në punë dhe në mbajtjen e raporteve. Përkundër kësaj numri i anëtarëve të regjistruar është fare modest, 60 lexues gjata tërë vitit.

|                        |     |
|------------------------|-----|
| Anëtarë të regjistruar | 60  |
| Libra të lexuara       | 348 |

### ***Dega në Bardhosh***

Pas transferimit të kësaj biblioteke në objekt të ri dhe të renovuar në kuadër të Shtëpisë së Kulturës, janë përmirësuar kushtet për punë. Objekti i bibliotekës gjendet pranë shkollës fillore të këtij fshati dhe kjo ka ndikuar dukshëm në rritjen e numrit të anëtarëve të regjistruar. Është dyfishuar numri i lexuesve dhe shërbimeve. Lokali ka hapësirë për vendosje të librave dhe për lexim, e kjo ka ndikuar që numri i shfrytëzuesve të sallës të jetë 616 veta.

|                        |      |
|------------------------|------|
| Anëtarë të regjistruar | 333  |
| Libra të lexuara       | 3584 |

### ***Dega në Hajvali***

Pas bartjes së koleksioneve të bibliotekës në objektin e shkollës fillore të këtij fshat, që u bë kah fundi i këtij viti, numri i anëtarëve të regjistruar ka pësuar një rritje të befasishme. Krahasuar me vitin paraprak është dyfishuar numri i lexuesve, por hapësira për koleksionet dhe për lexim janë fare të papranueshme.

|                        |      |
|------------------------|------|
| Anëtarë të regjistruar | 428  |
| Libra të lexuara       | 4329 |

### ***Dega në Slivovë***

Në këtë degë nuk ka interesim për bibliotekën. Anëtarë të kësaj biblioteke, kryesisht janë nxënësit. Nuk ka rritje të numrit të anëtarëve të regjistruar edhe përkundër regjistrimit falas.

|                        |    |
|------------------------|----|
| Anëtarë të regjistruar | 71 |
|------------------------|----|

***Dega në Keqekollë***

Me 2 tetor të vitit 2003 në mënyrë solemne u bë rihapja e kësaj dege të bibliotekës që ishte një ngjarje e rëndësishme për banorët e këtij fshati. Objekti është në kuadër të Shtëpisë së kulturës dhe është mjaft i përshtatshëm, sa në asnjë degë tjetër në fshatra, pasi ka hapsirë për lexim në sallë dhe për depozitim të librit. Renovimin dhe pajisjen me inventar e financoi Drejtorati për Kulturë i Komunës së Prishtinës. Punëtori i ri e bëri një trajnim rreth punës me lexues dhe veprimtarisë bibliotekare në përgjithësi më parë në Bibliotekën qendrore. Për një kohë kaq të shkurtër pati një numër të konsiderueshëm të lexuesve.

Anëtarë të regjistruar

225

Libra të lexuara

717

***Spektori i punëve të përbashkëta***

Punët që kreu ky sektor janë ndër më të ndryshmet. Janë evidencuar të gjitha hyrje-daljet e mjeteve materiale, si nga anëtarësimi i lexuesve, ashtu edhe mjeteve të ndara nga Ministria e Kulturës. U bë kalkulimi dhe regjistrimi i të gjitha faturave dalëse të këtyre mjeteve, është përgatitur raporti financiar çdo tre muaj dhe është dërguar në Ministrinë e Kulturës. Janë evidencuar dhe sistemuar të gjitha dokumentat zyrtare. Është bërë furnizimi i të gjithë sektorëve dhe degëve me material bibliotekar dhe të pastrimit. Është intervenuar në raste të ndryshme për riparimin e defekteve të paraqitura dhe kujdesur për mirëmbajtjen e objektit të vjetëruar në të gjitha degët.

Ky sektor është kujdesur edhe për mbajtjen e evidences së përditshme, pushimeve vjetore dhe mjekësore si dhe për respektimin e orarit të punës në bibliotekë.

Spektori i punëve të përbashkëta është kujdesur dhe ka mbikqyrë edhe punën e pastrimit të objektit të bibliotekës dhe të degëve të saj. Sipas vlerësimit të bërë, pastrimi ka qenë deri diku në nivel. Në të ardhmen do të bëhen përpjekje që pastrimi të jetë në nivel më të lartë.

***Bashkëpunimi***

Bashkëpunimi i Bibliotekës ishte i ngushtë me Bibliotekën Kombëtare dhe Univerzitare dhe me bibliotekat e tjera të vendit, e në rend të parë me pesë komunale të rrethit të Prishtinës, ku përfshihen bibliotekat e pesë qendrave:

të Besianës, Fushë Kosovës, Kastriotit, Drenasit dhe Lypjanit. Kontaktet me këto biblioteka ishin të herëpashershme dhe u ndihmuan me libra, me material bibliotekar, me udhëzime profesionale, madje edhe drejtpërdrejt me angazhim të punonjësve tanë në rregullimin e bibliotekave të tyre. Një ekip i Sektorit të Përpunimit të librit punoi dy ditë në bibliotekën e Lypjanit, duke e ndihmuar në organizimin e sektorëve, klasifikimin dhe sistemimin e fondit të koleksioneve.

### ***Realizimi i shërbimeve të përgjithshme***

|                                   |                             |
|-----------------------------------|-----------------------------|
| Pranimi i librit                  | 1302 tituj, 5017 ekzemplarë |
| Inventarizimi                     | 6292+526 (të ripunuar)      |
| Klasifikimi                       | 5760                        |
| Katalogimi                        | 1613                        |
| Skedarë të librit                 | 8043                        |
| Anëtarë të regjistruar            | 4173                        |
| Libra të lexuar                   | 60566                       |
| Gazeta të lexuara                 | 43850                       |
| Revista të lexura                 | 8157                        |
| Shfrytëzues të sallave të leximit | 63079                       |

***Prishtinë,  
9.02.2003***

***Drejtori,  
Sylejman Pireva***

***DREJTORATIT PËR KULTURË RINI, SPORT DHEGJINI  
TË KOMUNËS SË PRISHTINËS***

***BIBLIOTEKA NDËRKOMUNALE "HIVZI SULEJMANI"  
NË PRISHTINË***

***PROGRAMI I PUNËS PËR VITIN 2004***

***PRISHTINË, SHKURT 2004***